



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2022

**VENDIM**

**Nr. 146, datë 07.04.2022**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Diamela Goxha (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Migena Laska si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1 e 22, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bekteshi (relator), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Arbana Selmanaj si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Matilda Llangozi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1 e 22, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Arbër Çela dhe Hasan Selimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Hasan Selimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Izabela Radovani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen civile me Padi të: {...}, {...}, etj.; Të paditur: {...}; Objekti: “Zgjidhjen e kontratës së shitblerjes nr. {...} rep, nr.933 kol, datë 30.10.2013, etj.”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Izabela Radovani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen civile me Padi të: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Izabela Radovani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen civile me Padi të: {...}, etj.; I paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi jashtëkontraktor, etj.”

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: I pandehur: {...}; Akuza: “Neni 178 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Rishikim vendimi”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Kërkuës: {...}; Objekti: “Rivlerësim mase mjekësore”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Kërkuës: {...}; Objekti: “Heqje zotësie për të vepruar”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Kërkuës: {...}; Objekti: “Shpallje vdekje”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Shpëtime Pitaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen civile me Padi të: {...}; E paditur: Shoqëria "{...}"; Objekti: "Zbatim marrëveshje".

### **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi (relatore), Sokol Pina dhe Miranda Andoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit".

### **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Padi të: {...}, etj.; E paditur: {...}; Objekti: "Sigurim padie".

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

Kërkesës nr. 939 prot., datë 30.12.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore nr. 1259 regj., datë 18.10.2018, me kërkuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të pandehur: {...}, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës".

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit".

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**